

PLUS COMMUNICATION sh.a

**Raporti i auditorit te pavarur dhe
Pasqyrat financiare
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2010**

PERMBAJTJA

	Faqja
Raporti i auditorit te pavarur	
Pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2010	4
Pasqyra permbledhese e te ardhurave per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2010	5
Pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin aksionar me 31 dhjetor 2010	6
Pasqyra e rrjedhes se parase per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2010	7
Shenime mbi pasqyrat financiare	8 – 35

RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR

Aksionareve te Plus Communication sh.a.:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te Plus Communication sh.a. ("Shoqeria"), bashkangjitur, te cilat perfshijne pasqyren e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2010, pasqyren permbledhese te te ardhurave, pasqyren e ndryshimeve ne kapitalin aksionar, pasqyren e rrjedhes se parase per vitin e mbyllur ne kete date, si dhe nje permbledhje te parimeve baze kontabel dhe informacione te tjera shpjeguese .

Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar dhe per kontrollin e brendshem i cili, ne masen qe percaktohet nga Drejtimi, eshte i nevojshem per te bere te mundur pergatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktesi materiale si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Pergjegjesia e Auditorit

Pergjegjesia jone eshte qe bazuar ne auditimin tone, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tone ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarde, kerkojne qe ne te permbushim kerkesat e etikes dhe te planifikojme dhe te kryejme auditimin, me qellim qe te perftojme siguri te arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk kane pasaktesi materiale.

Auditimi perfshin kryerjen e procedurave per sigurimin e te dhenave te auditimit, per vlerat dhe deklarimet ne pasqyrat financiare. Procedurat e perzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, perfshi ketu dhe vleresimin e rrezeqeve te ekzistences se gabimeve ne pasqyrat financiare, qofshin keto si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjate vleresimit te rrezeqeve, auditori merr ne konsiderate kontrollin e brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te pasqyrave financiare, por jo per qellimin e shprehjes se nje opinion mbi efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit. Nje auditim perfshin gjithashtu vleresimin per pershtatshmerine e parimeve kontabel te perdorura dhe arsyeshmerine e vleresimeve kryesore te bera nga drejtuesit, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se te dhenat e auditimit qe kemi marre ofrojne baza te mjaftueshme dhe te pershtatshme per dhenien e opinionit te auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tone pasqyrat financiare paraqesin ne menyre te drejte, ne te gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar te Shoqerise me 31 dhjetor 2010, si dhe rezultatin e operacioneve te saj dhe rrjedhes se parase per vitin e mbyllur me kete date, ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar.

Deloitte Albania shpk

15 mars 2011

Tiranë, Shqipëri

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see <http://www.deloitte.al/about> for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

Member of Deloitte Touche Tohmatsu Limited

Plus Communication sh.a.**Pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2010***(vlerat ne mije LEK, nese nuk shprehet ndryshe)*

	Shenime	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale, neto	5	2,787,729	24,594
Aktive afatgjata jo materiale, neto	6	1,222,835	948,168
Llogari te arketueshme afatgjata		8,900	-
Aktive per tatimin e shtyre	7	-	4,315
Totali i aktiveve afatgjata		4,019,464	977,077
Aktive afatshkurtra			
Inventare, neto		21,468	44
Llogari te arketueshme		4,968	-
Aktive te tjera afatshkurtra	8	407,422	24,079
Parapagime per tatim fitimin		260	60
Depozita te vendosura si garanci	9	349,742	
Paraja dhe ekuivalentet e saj	10	1,681,526	182,419
Totali i aktiveve afatshkurtra		2,465,386	206,602
TOTALI I AKTIVEVE		6,484,850	1,183,679
Kapitali aksionar			
Kapitali i nenshkuar	11	1,047,558	1,042,320
Humbje e mbartur		(984,633)	(48,557)
Totali i kapitali aksionar		62,925	993,763
Detyrime afatgjata			
Borxhi afatgjate	15	2,348,557	-
Detyrime per tatimin e shtyre	7	140	-
Obligacione te konvertueshem	16	-	169,125
Totali i detyrimeve afatgjata		2,348,697	169,125
Detyrime afatshkurtra			
Obligacione te konvertueshem	16	2,775,400	-
Llogari te pagueshme	17	1,184,290	10,748
Detyrime ndaj paleve te lidhura	18	59,147	8,500
Te ardhura te periudhave te ardhshme		6,722	-
Detyrime te tjera afatshkurtra	19	47,669	1,543
Totali i detyrime afatshkurtra		4,073,228	20,791
TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE		6,484,850	1,183,679

Pasqyra e pozicionit financiar duhet te lexohet e shoqeruar me shenimet e faqeve 8 deri ne 35, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Plus Communication Sh.a.**Pasqyra permbledhese e te ardhurave per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2010***(vlerat ne mije LEK, nese nuk shprehet ndryshe)*

	Shenime	31 dhjetor 2010	Per periudhen nga 10 qershor 2009 (data e krijimit) deri me 31 dhjetor 2009
Te ardhura operative			
Te ardhura nga telekomunikacioni	20	9,969	-
Shitja e aparateve dhe aksesoreve		3	-
Totali i te ardhurave operative		9,972	-
Kostoja e shitjeve dhe sherbimeve te ofruara			
Kostoja e sherbimeve te ofruara		(403,407)	(20,776)
Kostoja e aparateve dhe aksesoreve		(3)	-
Kostoja totale e shitjeve dhe sherbimeve te ofruara	21	(403,410)	(20,776)
Humbja bruto		(393,438)	(20,776)
Shpenzime shitjeje, te pergjithshme dhe administrative	22	(480,755)	(47,161)
Rezultati nga aktivitetet operative		(874,193)	(67,937)
Te ardhurat financiare, neto			
Shpenzime te tjera financiare, neto		(3,284)	-
(Humbja) / fitimi nga kurset e kembimit, neto		(43,476)	15,016
Shpenzime nga interesi	15,16	(35,999)	-
Te ardhura nga interesi		25,330	49
Totali i (shpenzimeve) / te ardhurave financiare, neto		(57,429)	15,065
Humbja para tatimit		(931,622)	(52,872)
(Shpenzim) / rimarrje tatimi mbi fitimin	23	(4,454)	4,315
Humbja neto per periudhen		(936,076)	(48,557)
Te ardhura te tjera permbledhese		-	-
Totali i te ardhurave permbledhese		(936,076)	(48,557)

Pasqyra permbledhese e te ardhurave duhet te lexohet e shoqeruar me shenimet e faqeve 8 deri ne 35 te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Plus Communication Sh.a.**Pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin aksionar me 31 dhjetor 2010***(vlerat ne mije LEK, nese nuk shprehet ndryshe)*

	Shenime	Kapitali i nenshkruar	Rezerva Ligjore	Humbje mbartur	Totali
Kapitali i derdhur me 10 qershor 2009		1,042,320	-	-	1,042,320
Humbja e periudhes		-	-	(48,557)	(48,557)
Gjendje me 31 dhjetor 2009	11	1,042,320	-	(48,557)	993,763
Kontributi nga aksionaret		5,238	-	-	5,238
Humbja e vitit		-	-	(936,076)	(936,076)
Gjendje me 31 dhjetor 2010	11	1,047,558	-	(984,633)	62,925

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet te lexohet e shoqeruar me shenimet e faqeve 8 deri ne 35, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Plus Communication Sh.a.

Pasqyra e rrjedhes se parase per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2010

(vlerat ne mije LEK, nese nuk shprehet ndryshe)

	Shenime	31 dhjetor 2010	Per periudhen nga 10 qershor 2009 (data e krijimit) deri me 31 dhjetor 2009
Rrjedha e parase nga aktivitetet operative			
Humbje neto para tatimit		(931,622)	(52,872)
<i>Rregullime per:</i>			
Zhvleresimin dhe amortizimin	5,6	55,285	357
Te ardhura nga interesi		10,670	(49)
Diferenca te perealizuara nga kurset e kembimit		39,091	17
Shpenzime te perlllogaritura per qira		22,583	69
Blerje jo monetare per aktivet afatgjata materiale		(1,110,649)	(5,372)
Fatura te mberritura per blerje aktivesh		(19,243)	
Humbja operative perpara ndryshimeve ne kapitalin punues		(1,933,885)	(57,850)
Rritje ne llogari te arketueshme		(4,968)	-
Rritje ne inventare		(27,807)	(44)
Rritje ne aktivet e tjera afatshkurtra		(275,385)	(24,036)
Rritje ne llogarite e arketueshme afatgjata		(8,741)	-
Rritje ne depozitat e vendosura si garanci		(349,742)	
Rritje ne detyrimet ndaj paleve te lidhura		50,646	8,495
Rritje ne llogarite e pagueshme		1,162,932	10,667
Rritje ne te ardhurat e periudhave te ardhshme		6,723	-
Rritje ne detyrimet e tjera		14,796	1,543
Rrjedha e parase e perdorur ne aktivitetet operative		(1,365,431)	(61,225)
Tatim fitimi i paguar		(200)	(60)
Rrjedha neto e perdorur ne aktivitetet operative		(1,365,631)	(61,285)
Rrjedha e parase nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale		(185,716)	(948,168)
Blerje e aktiveve afatgjata materiale		(1,796,723)	(19,580)
Parapagime per aktivet afatgjata		(75,502)	-
Interes i arketuar		18,504	7
Rrjedha neto e perdorur ne aktivitetet investuese		(2,039,437)	(967,741)
Rrjedha e parase nga aktiviteve financuese			
Arketime nga obligacionet e konvertueshme		2,581,541	169,125
Kapitali i nenshkruar		5,238	1,042,320
Arketime nga borxhin afatgjate		2,317,396	-
Rrjedha neto e gjeneruar nga aktiviteve financuese		4,904,175	1,211,445
Rritja neto e parase dhe ekuivalenteve te saj	10	1,499,107	182,419
Paraja dhe ekuivalentet e saj ne fillim te periudhes		182,419	-
Paraja dhe ekuivalentet e saj ne fund te vitit		1,681,526	182,419

Pasqyra e rrjedhes se parase duhet te lexohet e shoqeruar me shenimet e faqeve 8 deri ne 35, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Keshilli i Administrimit te Shoqerise Plus Communication sh.a ka aprojuar keto pasqyra financiare me 1 mars 2011, dhe i kane firmosur ne emer te tyre:

Moni BUCHNIK
Drejtor i pergjithshem



Matilda SHEHU
Drejtoresh e Finances

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Plus Communication sh.a (ketu e ne vijim referuar si “Shoqeria”) eshte themeluar si shoqeri aksionere me 10 qershor 2009.

Shoqeria ka ndryshuar emrin nga Mobile 4 AL sha ne Plus Communication bazuar ne Vendimin e Keshillit Administrative me 22 qershor 2010.

Adresa e regjistruar e drejtuesve te shoqerise dhe aktivitetit kryesor te biznesit eshte Rruga “Deshmoret e 4 Shkurtit”, Godina e Re, prane Gardes se Republikes, Kati i 2, Tirane, Shqiperi.

Plus Communication zoteron license (Autorizim Individual) per ofrimin e sherbimeve te telekomunikacionit si E-GSM dhe GSM 1800 ne Shqiperi per 15 vjet.

2. APLIKIMI I STANDARDEVE NDERKOMBETARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF) TE REJA DHE TE RISHIKUARA

2.1 Standarde dhe Interpretime efektive per periudhen raportuese

Ndryshimet e meposhtme te standardeve ekzistuese te publikuara nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve te Raportimeve Financiare Nderkombetare jane ne fuqi per periudhen raportuese:

- **SNRF 3 i Rishikuar “Kombinimet e Biznesit”** (efektiv per periudha vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 korrik 2009),
- **SNK 27 i ndryshuar “Pasqyrat Financiare te Konsoliduara dhe te Veçanta”** (efektiv per periudha vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 korrik 2009),
- **Ndryshimet ne SNRF 1 “Adoptimi i Standardeve Nderkombetare te Raportimit Financiar per Here te Pare”**- Perjashtimet Shtese per Aplikuesit per here te Pare (efektiv per periudha vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2010),
- **Ndryshimet ne SNRF 1 “Adoptimi i Standardeve Nderkombetare te Raportimit Financiar per Here te Pare”**- Zevendesimi i 'datave fikse' per disa perjashtime me 'daten e kalimit ne SNRF' (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 korrik 2011),
- **Ndryshimet ne SNRF 1 “Adoptimi i Standardeve Nderkombetare te Raportimit Financiar per Here te Pare”** – Perjashtime shtese per njesi qe ndalojne se prekuri nga hiperinflacioni i rende (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 korrik 2011),
- **Ndryshimi ne SNRF 2 “Pagesat e Bazuara ne Aksione”** - Transaksionet e pagesave ne grup te bazuara ne aksione te cilat ekzekutohen me para ne dore (efektiv per periudha vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2010),
- **Ndryshimi ne SNK 12 “Tatimi mbi te ardhurat”** - Ndryshim me shtrirje te kufizuar (mbulim i aktiveve themelore) (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2012),
- **Ndryshimet ne SNK 39 “Instrumentat Financiare: Njohja dhe Matja”** - Instrumentet mbrojtjes (efektiv per periudha vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 korrik 2009). Standardi i rishikuar shpjegon dy çështje te kontabilitetit per mbrojtjen kontabel: duke identifikuar inflacionin si nje rrezik te mbrojtur ose pjese te tij dhe mbrojtjen me opsione,
- **KIRFN 17 “Shperndarja e Aktiveve Jo Monetare Pronareve”** (efektiv per periudha vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 korrik 2009). Interpretimi ofron udhezues mbi trajtimin e pershtatshem kontabel kur nje njesi ekonomike i shperndan aksionareve te saj si dividende aktive te ndryshme nga ato monetare,

2. APLIKIMI I STANDARDEVE NDERKOMBETARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF) TE REJA DHE TE RISHIKUARA (VAZHDIM)

2.1 Standarde dhe Interpretime efektive per periudhen raportuese (vazhdim)

- **KIRFN 18 “Transferimi i Aktiveve nga Klientet”** (efektiv per transferimin e aktiveve nga klientet me apo pas dates 1 korrik 2009),
- **Ndryshimet e standardeve e interpretimeve “Ndryshimet mbi Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (2009)”** qe rezultojne nga Projekti i Permiresimit Vjetor te Cilesise se SNRF, te publikuara me date 16 prill 2009 (SNRF 2, SNRF 5, SNRF 8, SNK 1, SNK 7, SNK 17, SNK 18, SNK 36, SNK 38, SNK 39, KIRFN 9, KIRFN 16) me synim paresor heqjen e mosperputhjeve e qartesimin e te shprehurit (shumica e ndryshimeve duhet te aplikohen per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2010).

Keto ndryshime ne standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk kane ndikuar ne politikat kontabel, pozicionin financiar dhe performancen e Shoqerise.

2.2. Standarde dhe interpretime ne publikim akoma jo ne fuqi

Ne daten e autorizimit te ketyre pasqyrave financiare standardet, permiresimet dhe interpretimet e meposhtme jane publikuar por nuk jane akoma ne fuqi.

Asnje prej tyre nuk pritet te kete efekt te ndjeshem ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

- **SNRF 9 “Instrumentat Financiare”** (efektiv per periudha vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2013), **Megjithate, nuk eshte praktike te jepet nje vleresim i arsyeshem i efektit ne shumat e raportuara ne lidhje me aktivet dhe detyrimet financiare, deri sa nje rishikim i detajuar te jete perfunduar,**
- **Ndryshimi ne SNRF 1 “Adoptimi i Standardeve Nderkombetare te Raportimit Financiar per Here te Pare”**- Perjashtimi i Kufizuar nga Paraqitjet Krahasuese te SNRF 7 per aplikuesit per here te pare (efektiv per periudha vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 korrik 2010),
- **Ndryshimi ne SNRF 7 “Instrumentat Financiare: Dhenie informacionesh shpjeguese”** – Transferimi i aktiveve financiare (efektiv per periudha vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 korrik 2010),
- **Ndryshimet ne SNK 24 “Dhenie e informacioneve shpjeguese per Palet e Lidhura”** – Duke thjeshtuar kerkesat per publikim per njesite ekonomike shteterore dhe duke qartesuar perkufizimin e nje pale te lidhur (efektiv per periudha vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2011),
- **Ndryshimi ne SNK 32 “Instrumentat Financiare: Paraqitja”** – Kontabilizimi per leshimin e te drejtave (per periudha vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 shkurt 2010),
- **Ndryshimet e standardeve e interpretimeve “Permiresimet mbi Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar 2010”** qe rezultojne nga Projekti i Permiresimit Vjetor te Cilesise se SNRF, te publikuara me 6 maj 2010. (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 7, SNK 1, SNK 27, SNK 34, KIRFN 13) me qellimin kryesor per heqjen e mosperputhjeve e qartesimin e te shprehurit. (shumica e ndryshimeve duhet te aplikohen per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2011),
- **Ndryshimet e KIRFN 14 “SNK 19 — Limit mbi nje Aktiv me perfitim te percaktuar, kerkesat e Financimit Minimal dhe Nderlidhja mes tyre”** – Parapagimet e nje Kerkese Minimale per Financim (efektiv per periudha vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2011),

2. APLIKIMI I STANDARDEVE NDERKOMBETARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF) TE REJA DHE TE RISHIKUARA (VAZHDIM)

2.2. Standarde dhe interpretime ne publikim akoma jo ne fuqi (vazhdim)

- **KIRFN 19 “Mbyllja e Detyrimeve financiare me Instrumenta Kapitali”** (efektiv per periudhat raportuese qe fillojne me ose pas dates 1 korrik 2010).

3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL

3.1. Baza e perputhshmerise

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF).

3.2. Baza e pergatitjes

(a) Baza e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne baze te koston historike.

(b) Monedha raportuese dhe funksionale

Keto pasqyra financiare jane paraqitur ne (“LEK”), e cila eshte monedha funksionale e Shoqerise. Te gjitha informacionet financiare te paraqitura ne (“LEK”) jane rrumbullakosur ne mijeshen me te afert (nese nuk thuhet ndryshe).

3.3. Permbledhje e politikave kontabel

Politikat kontabel te paraqitura me poshte do te aplikohen ne menyre konsistente ne te gjitha periudhat.

(a) Monedhat e huaja

Transaksionet ne monedhe te huaj jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates ne te cilen eshte kryer transaksioni. Aktivet dhe pasivet monetare ne monedhe te huaj ne daten e mbylljes se pasqyres se pozicionit financiar jane rivleresuar ne monedhen funksionale sipas kursit te kembimit ne daten raportimit.

Zerat jo monetare qe jane matur me kosto historike ne monedhe te huaj nuk jane rivleresuar.

Diferencat qe rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen ne pasqyren permbledhese te ardhurave, me perjashtim te rastit kur diferencat lindin si rezultat i rikonvertimit te instrumentave te kapitalit te mbajtur per shitje (nese ka).

(b) Instrumentat financiare

Instrumentat financiare te Shoqerise gjate vitit 2010 dhe ne fund te vitit 2009 perbeheshin nga instrumentat joderivative: paraja dhe ekuivalentet e saj, llogari te arketueshme, detyrime te tjera te pagueshme dhe obligacione te konvertueshem.

Shoqeria nuk zoteron instrumenta financiare me vlere tregu ose te mbajtura per shitje, si edhe garanci financiare gjate vitit 2010 dhe vitit 2009.

i. Njohja fillestare

Nje instrument financiar njihet nese Shoqeria behet pale e dispozitave kontraktuale te instrumentit ne fjale. Blerjet dhe shitjet e rregullta te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e tregetimit, psh. data ne te cilen Shoqeria angazhohet ne blerjen apo shitjen e nje aktivi financiar.

Instrumentat jo-derivative njihen fillimisht me vleren e drejte, ndersa atyre instrumentave qe s’jane me vlere te drejte, permes pasqyres permbledhese te te ardhurave, iu shtohet çfaredolloj kosto transaksioni qe mund t’i ngarkohet drejtperdrejt instrumentit financiar.

ii. Njohja e metejshme

Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj perfshijne tepricat e arkes dhe llogarite rrjedhese ne banke dhe depozita te cilat jane lehtesisht te konvertueshme ne para dhe kane nje rrezik te vogel te renies se vleres.

3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

3.3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

(b) Instrumentat financiare (vazhdim)

Huate

Detyrimet financiare perfshire borxhet, jane njohur fillimisht me vleren e tregut neto nga kostot e transaksioneve dhe me pas njihen me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv, me shpenzime interesi te njohura me normen efektive.

Metoda e interesit efektiv eshte metoda e llogaritjes te koston se amortizuar te detyrimit financiar dhe te shperndarjes se shpenzimit te interesit pergjate periudhes perkatese. Norma e interesit efektive eshte norma qe skonton saktesisht vlerat e ardhshme te parave gjate viteve te planifikuara te detyrimit financiar, ose, kur eshte e pershtatshme ne nje peridhe me te shkurter.

Detyrime te pagueshme dhe te tjera

Detyrimet e pagueshme dhe te tjera jane matur ne vijim me koston e tyre te amortizuar.

iii. Zhvleresimi i aktiveve financiare

Nje aktiv financiar konsiderohet si i zhvleresuar ne ato raste kur ekzistojne kushte objektive qe tregojne se nje apo me shume ngjarje pas njohjes se tij fillestare kane patur efekt negativ ne rrjedhen e ardhshme te parase se atij aktivi (nese ka).

iv. C'rregjistrimi

Aktivitet financiare c'rregjistrohen nese te drejtat kontraktuale te Shoqerise per rrjedhen e parase nga aktivet financiare skadojne. Detyrimet financiare c'rregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te Shoqerise te percaktuara ne kontrate skadojne apo jane anuluar.

v. Netimi i instrumentave financiare

Aktivitet dhe pasivet financiare netohen dhe shuma e tyre raportohet neto ne pasqyren e pozicionit financiar nese, dhe vetem nese egziston nje e drejte e detyrueshme ligjore per te netuar shumen e njohur dhe egziston mundesia per te shlyer shumen neto, apo per te realizuar aktivin dhe shlyer pasivin ne te njejten kohe.

(c) Obligacione te konvertueshem te leshuara nga Shoqeria

Klasifikimi si borxh apo kapital

Instrumentat e borxhit dhe te kapitalit jane klasifikuar si detyrime financiare apo kapital ne perputhje me permbajtjen e marreveshjes kontraktuale.

Instrumentat e kapitalit

Instrument kapitali eshte cdo kontrate qe evidenton interes te mbetur ne aktivet e Shoqerise pasi jane zbritur te gjitha detyrimet e saj. Instrumentet e kapitalit te leshuar nga Shoqeria njihen me shumet e arketimeve te marra neto nga kostot e leshimit.

Instrumentat komplekse

Pjeset perberese te instrumentave komplekse (obligacione te konvertueshem) leshuar nga Shoqeria jane klasifikuar vecmas si detyrime financiare dhe kapital ne perputhje me permbajtjen e marreveshjes kontraktuale. Ne daten e leshimit vlere e drejte e borxhit eshte llogaritur duke perdorur normen e interesit mbizoteruese te tregut per instrumenta te ngjashem te pa-konvertueshem.

Kjo vlere eshte regjistruar si detyrim mbi bazen e koston se amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektive deri sa te shuhet nepermjet konvertimit ose ne daten e maturimit te instrumentit. Instrumenti i kapitalit eshte percaktuar duke zbritur vleren e komponentit te borxhit nga vlere e drejte e instrumentit kompleks.

3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

3.3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

(d) Aktivet afatgjata materiale

i. Njohja dhe Matja

Zerat e aktiveve afatgjata materiale jane matur me kosto minus zhvleresimin e akumuluar dhe humbjet nga renia ne vlere (nese ka). Aktivet ne proces jane matur ne kosto minus ndonje humbjet nga renia ne vlere (nese ka). Programi kompjuterik i blere qe eshte thelbesor per funksionimin e pajisjes perkatese, kapitalizohet si pjese e kesaj pajisjeje. Kur pjeset e nje zeri te aktiveve afatgjata materiale kane jetegjatesi te ndryshme perdorimi, ato kontabilizohen si zera te vecante (komponentet kryesore) te aktiveve afatgjata materiale.

ii. Zhvleresimi

Zhvleresimi njihet ne pasqyren permbledhese te te ardhurave duke perdorur metoden lineare, sipas jetes ekonomike te parashikuar te perdorimit. Toka dhe aktivet ne proces nuk zhvleresohen.

Jetegjatesia e parashikuar dhe normat e zhvleresimit te aktiveve per periudhen aktuale jane si me poshte:

Kategorite e aktiveve materiale	Jetegjatesi e perdorimit	Normat e zhvleresimit
Ndertese administrate	5-10 vjet	10% - 20 %
Ndertesa rrjeti	7-15 vjet	6.7 %-14 %
Sisteme dhe instalime telekomunikacioni	3-10 vjet	10 %-33 %
Mjete transporti	5 vjet	20 %
Pajisje zyre	5 vjet	20 %
Programe dhe pajisje informatike	3-5 vjet	20 %-33 %

Zhvleresimi dhe amortizimi nuk eshte llogaritur per punimet ne proces. Zhvleresimi / amortizimi fillon te llogaritet 3-6 muaj pasi site eshte on-air.

iii. C'rregjistrimi

Nje aktiv afatgjat material c'rregjistrohet kur ai nxirret jashte perdorimit apo kur nuk priten me perfitime ekonomike ne te ardhmen nga perdorimi apo nxjerrja jashte perdorimit te tij (nese ka).

Fitimet dhe humbjet ne rastin e nxjerrjes jashte perdorimit te aktiveve afatgjata materiale jane percaktuar sipas shumes se tyre te mbetur dhe merren parasysh ne percaktimin e rezultatit operativ te ushtrimit.

(e) Aktivet afatgjata jo materiale

Aktivt afatgjata jo materiale perfshijne licensat, te drejtat per perdorim si dhe software.

(i) Njohja dhe matja

Licensat dhe te drejtat e perdorimit te cilat jane perfituar nga Shoqeria jane paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga renia ne vlere (nese ka).

(ii) Amortizimi

Amortizimi njihet ne pasqyren permbledhese te te ardhurave duke perdorur metoden lineare sipas jetes ekonomike te parashikuar te perdorimit (qe nga data qe ato jane te gatshme per t'u perdorur). Jetegjatesia e parashikuar dhe normat e amortizimit te aktiveve jane si me poshte:

Kategorite e aktiveve jo materiale	Jetegjatesi e perdorimit	Normat e amortizimit
Licensa	14 vjet	7.23 %
Programe kompjuterike (software)	3-10 vjet	10 %-33%

Amortizimi i licenses llogaritet sipas jetegjatesise se perdorimit. Jetegjatesia e licenses ka filluar nga data qe rrjeti eshte vene ne pune.

3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

3.3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

(f) Renia ne vlere

Shoqeria rishikon ne cdo date raportimi, shumen e mbartur te aktiveve materiale dhe jo materiale ne menyre qe te percaktoje nese ekziston ndonje tregues qe keto aktive te kene pasur humbje si rezultat i nje renie ne vlere.

Ne rast se keto tregues ekzistojne atehere vleresohet vlere e rikuperueshme e aktivitet me qellim qe te percaktohet masa e humbjes, nese ka. Ne rast se nuk eshte e mundur te vleresohet vlere e rikuperueshme per nje aktiv te vecante, Shoqeria vlereson vleren e rikuperueshme te rrjedhes te parase te gjeneruar nga njesia se ciles i perket aktiviteti.

Vlere e rikuperueshme eshte vlere me e larte midis vleres se tregut minus kostot e shitjes dhe vleres se tij te perdorimit. Per te vleresuar vleren ne perdorim, rrjedhjet e ardhshme te parashikuara te parase aktualizohen nga vlere e tyre ekzistuese duke perdorur nje norme aktualizimi pa llogaritur tatimet, e cila reflekton vleresimet aktuale te tregut te vleres monetare ne kohe dhe rreziqet specifike qe kane lidhje me ate aktiv per te cilin vleresimi i rrjedhes se ardhshme te parase nuk eshte rregulluar.

Nese vlere e rikuperueshme e nje aktiviteti apo rrjedha e parase se gjeneruar eshte vleresuar te jete me i vogel se vlere kontabel, atehere vlere kontabel e aktivitet do te zvogelohet deri ne vleren e rikuperueshme te tij. Humbja nga renia ne vlere njihet menjehere ne pasqyren pambledhese te te ardhurave.

Nese nje humbje nga renia ne vlere rimerret, vlere kontabel apo rrjedha e gjeneruar e parase do te rriten deri ne vleren e rishikuar te rikuperueshme, duke mos kaluar vleren e mbartur te aktivitet qe do te ishte percaktuar ne rast se nuk do te ishte njohur asnje humbje nga renia ne vlere ne vitet paraardhese. Kthimi i humbjes nga renia ne vlere njihet menjehere ne pasqyren pambledhese te te ardhurave.

(g) Inventaret

Inventari perbehet kryesisht nga: karta SIM, karta rimbushese te parapaguara, aparate dhe aksesore te tjere, te paraqitura me vleren me te ulet midis kostos dhe vleres se realizueshme neto.

Vlere e realizueshme neto eshte çmimi i shitjes i perlllogaritur gjate rrjedhes normale te biznesit, pa koston e perlllogaritur te perfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

Kosto e inventareve eshte perlllogaritur duke u bazuar ne metoden e mesatares se ponderuar dhe perfshijne shpenzimet e kryera gjate blerjes se inventarit dhe sjelljes se tyre ne kushtet dhe vendndodhjen ekzistuese.

(h) Dividende

Shoqeria synon te njohe dividendet si detyrim ne periudhen ne te cilen jane deklaruar.

(i) Shpenzime per personelin

i. Kontributet per sigurimet shoqerore dhe shendetesore

Shoqeria, gjate aktivitetit te saj normal, kryen pagesa ne emer te saj dhe te punonjesve te saj per te kontribuar per sigurimet shoqerore dhe shendetesore ne pajtim me legjislacionin ne fuqi. Kostot perkatese te derdhura ne emer te Shoqerise ngarkohen ne pasqyren pambledhese te te ardhurave ne momentin qe ato ndodhin.

ii. Leja e zakonshme e paguar

Shoqeria njih si detyrim shumen e paskontuar te kostove te parashikuara ne lidhje me lejen e zakonshme qe pritet t'iu paguhet punonjesve ne kembim te sherbimit te tyre per periudhen e mbyllur.

iii. Plani i kompensimit me opsione ne aksione

Shoqeria do te perdore plan kompensimi me opsionin aksione per te shperblyer stafin drejtues kryesore te saj.

Planet e kompensimit me opsionin ne aksione jane pagesa te bazuara ne aksione qe shlyhen ne para dhe Shoqeria njih detyrim per mallrat dhe sherbimet e marra, te njohura fillimisht me vleren e drejte te detyrimit. Ne fund te periudhes raportuese derisa sa detyrimi shlyhet dhe ne daten e shlyerjes detyrimi rimatet dhe cdo ndryshim ne vleren e drejte njihet ne pasqyren pambledhese te te ardhurave.

3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

3.3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

(j) Provigjonet

Provigjonet njihen kur Shoqeria ka nje detyrim aktual (ligjor ose te terthorte) si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar per te cilen ka mundesi qe te krijohen nje rrjedhe burimesh te nevojshme per te permbushur detyrimin dhe kur nje perlllogaritje e besueshme e shumes se detyrimit mund te llogaritet.

Provigjonet rishikohen ne cdo date raportimi dhe nese nuk ka me mundesi per nevojen e nje rrjedhe burimesh qe perfshin perfitime ekonomike per shlyerjen e detyrimit, provigjonet rimerren. Provigjonet perdoren vetem per qellimin per te cilin jane njohur fillimisht.

Pasivet dhe aktivet e kushtezuara nuk njihen por vetem paraqiten ne shenimet e pasqyrave financiare kur jane materiale.

(k) Qirate

Qirate klasifikohen si qira financiare ose qira operative qe ne fillimin e qirase. Qirate financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare ne shkallen me me te voglen midis vleres se drejte te aktivitet dhe vleres aktuale te pagesave minimale te qirase ne daten e marrjes. Kosto financiare paraqet diferencen midis detyrimit total te qirase dhe vleres se drejte te aktivitet. Kostot financiare jane regjistruar ne pasqyren permbledhese te te ardhura gjate kohezgjatjes se qirase me norma interesi te aplikueshme mbi balancen e mbetur te detyrimeve.

(l) Njohja e te ardhurave

Shoqeria synon te njohet te ardhurat nga sherbimet e ofruara ne pasqyren permbledhese te te ardhurave ne proporcion me perfundimin e sherbimeve ne daten e raportimit.

Te ardhurat nga sherbimet kryesore konsistojne ne:

- (i)** Tarife abonimi / mujore,
- (ii)** Tarifat e sherbimit telefonik dhe sherbime te tjera te ofruara,
- (iii)** Tarifa e roaming-ut dhe
- (iv)** Tarifa e interkoneksionit.

Te ardhurat nga keto sherbime njihen si me poshte:

(i) Tarife abonimi / tarifa mujore

Te ardhurat qe lidhen me tarifen mujore njihen ne muajin ne te cilin ofrohet sherbimi i telekomunikacionit.

(ii) Sherbim telefonik dhe tarifa te tjera te ofruara

Tarifat e sherbimit telefonik jane tarifa te bazuara ne trafikun e krijuar nga thirresi, destinacionin e thirrjes dhe ne llojin e sherbimit te perdorur.

Tarifat e sherbimit telefonik varen nga trafiku, koha e bisedes se perdorur apo volumi i te dhenave te transmetuara per sherbimet me vlere te shtuar, si sherbimet e mesazheve te shkurtra, perdorimi i internetit dhe sherbimet e te dhenave.

Te ardhurat nga sherbimi telefonik dhe sherbimet me vlere te shtuar njihen ne periudhen kur sherbimet ofrohen. Te ardhurat e pafaturuara nga cikli i faturimit ne fund te cdo muaji, perlllogariten ne baze te trafikut dhe regjistrohen ne fund te muajit si te ardhura te perlllogaritura.

Te ardhurat nga shitja e kartave rimbushese me parapagese dhe kohes se bisedes per sherbimin me parapagese, neto nga uljet e lejuara, te perfshira ne paketat e sherbimit me parapagese te Shoqerise, njihen ne baze te perdorimit. Koha e paperdorur nga koha e ofruar ne paketen e parapaguar, regjistrohet si e ardhur e periudhave te ardhshme ne pasqyren e pozicionit financiar.

3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

3.3. Permbledhje e Politikave Kontabel (vazhdim)

(l) Njohja e te ardhurave (vazhdim)

(iii) Tarifa e roamingut

Sherbimet e roaming-ut do t'iu faturohen me cmim per njesi operatoreve wireless te roaming-ut per abonentet qe perdorin rrjetet e tyre ne vendin tone. Ne te njejten menyre edhe operatoret wireless do te faturojne Shoqerine per perdorimin e rrjeteve te tyre nga abonentet e Shoqerise ne vendet e tyre. Keto te ardhurat (dhe shpenzime) do te njihen ne periudhen ne te cilen sherbimet jane ofruar.

(iv) Tarifat e Interkoneksionit

Te gjitha perdoruesit qe kane nje numer Plus Communication si numer perfundues dhe abonentet e nje shoqerie tjeter si numer origjinues, krijojne nje marredhenie te ardhurash midis shoqerise tjeter dhe Plus Communication sh.a. E ardhura njihet si e ardhur interkoneksioni midis dy shoqerive.

Te ardhurat e interkoneksionit jane perftuar nga te gjitha thirrjet qe perfundojne ne rrjetin e Plus Communication sh.a nga rrjetet e operatoreve te huaj, vendas, fiks dhe celular qe perdorin rrjetin e Shoqerise.

Te gjitha thirrjet qe kane nje numer Plus Communication sh.a si numer origjinues dhe abonentin e nje shoqerie tjeter si numer perfundues, krijojne nje marredhenie kostoje midis shoqerise tjeter dhe Plus Communication sha. Kjo kosto njihet si kosto interkoneksioni midis dy shoqerive. Kostot e interkoneksionit perftoheshen nga te gjitha thirrjet e krijuara ne rrjetin e Plus Communication sh.a dhe te perfunduara ne rrjete te operatoreve te huaj, vendas, fiks dhe celular, duke perdorur rrjetet e shoqerive te tjera.

Shoqeria do t'iu paguaje operatoreve te tjere nje pjese te te ardhurave qe mbledh nga thirrjet e abonenteve te vet, per te gjitha thirrjet drejt rrjeteve te operatoreve te tjere te huaj, vendas, fiks dhe celular.

Keto te ardhura dhe shpenzime njihen ne pasqyren permbledhese te te ardhurave ne kohen kur thirrja merret/pranohet ne rrjetin e Shoqerise / operatoreve te tjere.

(m) Shpenzimet

Shoqeria synon te njohe shpenzimet ne pasqyren permbledhese te te ardhura ne proporcion me kryerjen e sherbimeve ne daten e raportimit.

(n) Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat nga interesi njihen ne pasqyren permbledhese te te ardhurave kur ato ndodhin duke marre ne konsiderate metoden e interesit efektiv (nese ka).

Shpenzimet per interesa perfshijne interesin e pagueshem mbi borxhin e marre duke perdorur metoden e normes efektive te interesit.

(o) Tatim fitimi

Tatim fitimi ne pasqyren permbledhese te te ardhurave perbehet nga tatimi aktual dhe tatimi i shtyre. Tatim fitimi njihet ne pasqyren permbledhese te te ardhurave pervec rasteve kur lidhet me zera qe njihen direkt ne kapital, rast ne te cilin edhe tatimi njihet ne kapital.

Tatimi aktual eshte tatimi i pritur per t'u paguar mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke aplikuar normat tatimore ne fuqi ne daten e raportimit, si edhe çfaredolloj rregullimi kontabel te tatimit per t'u paguar ne lidhje me vitet e meparshme.

Tatimi i shtyre llogaritet duke perdorur metoden e raportit financiar, duke vleresuar diferenca te perkohshme midis vleres kontabel te aktiveve dhe detyrimeve per raportin financiar dhe vleres kontabel per qellime tatimore. Diferencat e perkohshme nuk parashikohen per njohjen fillestare te aktiveve dhe detyrimeve qe nuk kane asnje ndikim mbi fitimin kontabel apo te tatueshem.

Shuma e tatimit te shtyre bazohet ne menyren e pritshme te realizimit apo shlyerjes se vleres se mbetur te aktiveve dhe detyrimeve, duke perdorur normat tatimore ne fuqi ne daten e pasqyres se pozicionit financiar.

Nje aktiv tatimor i shtyre eshte njohur vetem nese ka mundesi qe fitimi i tatueshem te jete i mundur ne periudhat e ardhshme kundrejt te cilit aktiv i mund te shfrytezohet. Aktivet tatimore te shtyra reduktohen deri ne shkallen ku nuk eshte me e mundur qe te realizohet perfitimi perkates.

3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

3.3. Permbledhje e Politikave Kontabel (vazhdim)

(p) Fitimet per aksion

Fitimet baze dhe te reduktura per aksion llogariten duke pjestuar fitimin neto me numrin mesatar te ponderuar te aksioneve gjate cdo viti.

4. VLERESIMET KRITIKE KONTABEL DHE BURIMET KRYESORE TE PASIGURIVE TE VLERESIMEVE

Shoqeria pergatit pasqyrat financiare ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar ("SNRF"), aplikimi i te cilave shpesh kerkon gjykime te bera nga drejtimi per pozicionin dhe rezultatin financiar. Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF) kerkojne qe drejtimi te zbateje keto standarde duke ju pershtatur kushteve te Shoqerise me qellim paraqitjen me vertetesi te pozicionit, rezultatit te Shoqerise dhe rrjedhes se parase.

Ne percaktimin dhe aplikimin e politikave kontabel, shpesh kerkohet gjykim, ne rastet kur zgjedhja e politikave te vecanta, vleresimeve ose supozimeve kontabel qe duhet ndjekur mund te ndikojne materialisht ne rezultatet e raportuara ose ne pozicionin neto te aktiveve te Shoqerise, ne rast se me vone percaktohet nje tjeter zgjedhje do te ishte me e pershtatshme.

Drejtimi i konsideron vleresimet dhe supozimet kontabel te diskutuara me poshte si vleresimet me kritike ne perputhje me rrethanat, duke dhene shpjegime perkatese.

4.1 Rishikimi i renies ne vlere

Rikuperimi i aktiveve eshte nje fushe qe perfshin gjykimet e menaxhimit, duke kerkuar vleresimin nese vlere kontabel e aktiveve mund te mbeshetet nga vlere neto aktuale e rrjedhes se ardhshme te parase qe rrjedhin nga aktive te tilla duke perdorur parashikimet e rrjedhes se parase te cilat jane skontuar ne nje norme te pershtatshme.

Ne llogaritjen e vleres aktuale neto te rrjedhes te ardhshme te parase, supozime te caktuara kerkohen te behen ne lidhje me ceshtje te pasigurta te cituara me poshte.

SNRF kerkojne nga Drejtimi te ndermarre teste vjetore per renien ne vlere te aktiveve me jete te papercaktuar, dhe aktivet me jete te percaktuar, nese ngjarjet apo ndryshimet e rethanave tregojne se vlere kontabel e aktivitet mund te mos rikuperohet. Drejtimi i Shoqerise synon te rishikojte aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale te pakten nje here ne vit per te percaktuar nese nje rishikim i plote per renien ne vlere eshte i nevojshem.

4.2 Vleresimi i jetes se perdorimit te aktiveve jomateriale

Jetegjatesia e perdorur per amortizimin e aktiveve jomateriale, lidhet me punen ne te ardhmen te aktivitet dhe gjykimin e Drejtimit per periudhen ne te cilen do te rrjedhin perfitime ekonomike nga aktiviteti.

4.3 Licensat dhe tarifat

